



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

## V E N D I M

### Nr. 186, Datë 16/12/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.71 Regj., datë 21.07.2016, e z. E. Z. kundër Bankës së Shqipërisë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

### K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se z. E. Z. ka filluar marrëdhënien e punës pranë Bankës së Shqipërisë në muajin korrik të vitit 2003, në pozicionin “jurist”, në Zyrën Juridike. Në muajin nëntor 2011 është emëruar në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Çështjeve të Brendshme të Departamentit Juridik. Subjekti ankues në datën 03.06.2014 deri me datë 9.06.2014 është shtruar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Pas diagnostikimit dhe trajtimit mjekësor, Komisioni Mjeko-Ligjor i ka rekomanduar pushim, me raporte mjekësore të paaftësisë së përkohshme për punë, për rreth dy muaj. Në datën 18.08.2014, z. E. Z. është paraqitur në punë. Ankuesi pretendon se që nga momenti i kthimit të tij në punë, kryesisht në 6-mujorin e dytë të vitit 2014, nga ana e Drejtorit

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “LMD”

<sup>2</sup> Tek “çdo shkak tjetër” ankuesi citon-bindjet dhe opinionet profesionale të shprehura në përmbushje të detyrimit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe interes publik në Institucionin e Bankës së Shqipërisë; paragjykimet politike lidhur me përkatësinë e tij, etj.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

dhe Zëvendësndrejtoreshës së Departamentit Juridik i është imponuar një ambjent jo i përshtatshëm për punë. Ankuesi pretendon se nuk i është dhënë asnjë informacion i nevojshëm, lidhur me detyrën e tij si Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Brendshme të Departamentit Juridik, si dhe se ai ka patur mosmarrëveshje parimore me këta dy drejtues, pasi ai mendon se ata tregonin papërgjegjshmëri në mënyrën e drejtimit të Departamentit Juridik. Z. E.Z.shprehet se kjo periudhë është shoqëruar me moszënie me punë dhe me mungesë transparence ndaj tij si Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Brendshme të Departamentit Juridik, duke pretenduar se ai është diskriminuar pas shprehjes së opinionëve të tij profesionale kryesisht mbi çështjet e mëposhtme:

1. Lidhur me mënyrën se si duhet të regjistroheshin në kontabilitet shumat e vjedhura në arkat e Departamentit të Emisionit.
2. Në lidhje me komandinin në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të z. E.C., ish-këshilltar në Kabinetin e BSH-së.
3. Lidhur me mos shpalljen e vendit vakant dhe mos zbatimin e procedurës së konkursit përse i përket ngritjes në detyrë të znj. S.H, nga Specialiste në Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve të Brendshme në Departamentin e Burimeve Njerëzore.

Subjekti ankues shprehet se është diskriminuar, pasi nuk pranonte të jepte opinione jashtë bindjeve të tij profesionale dhe se paragjykohej politikisht se “i përkiste krahut tjetër politik”, duke i mohuar atij çdo lloj informacioni profesional. Lidhur me këtë parashtron argumentet e mëposhtëm se:

1. *“I është hequr aksesimi në llogarinë e tij zyrtare të punës dhe në Modulin e Praktikave brenda Departamentit Juridik, nga muaji Shkurt i vitit 2015 e në vijim;*
2. *Refuzimi i përsëritur për t’u njohur me praktikat dokumentare të Çështjeve të Brendshme në BSH;*
3. *Si rezultat i udhëzimeve diskriminuese, ai pretendon se kolegët e tij ishin udhëzuar të mos shoqërohen me të dhe të mos i komunikonin atij praktikat profesionale;*
4. *Është diskriminuar përmes mohimit të të drejtave sociale lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike për shkak të ndarjes nga jeta të babait të tij, si dhe të ndërhyrjes së tij kirurgjikale; pasi gjatë periudhës 06.05.2015-11.05.2015 i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale jashtë shtetit dhe ka qenë me raport-mjekësor për një periudhë 6-mujore;*
5. *Pas kthimit në punë, atij nuk i janë plotësuar kushtet minimale të ambjentit të zyrës, pasi ankuesi pretendon se zyra nuk kishte as ndriçimin e duhur, çka i shkaktonte atij lodhje të shikimit dhe pamundësi për të punuar normalisht”.*

Z. E.Z.e konsideron këtë sjellje të punëdhënësit si tendencioze dhe diskriminuese, gjë që është përshkallëzuar me aktin nr. 14443, datë 26.03.2015, të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, për caktimin e masës disiplinore “*Ujje në detyrë*” me afat një vjeçar, duke vijuar me shkresën nr.6164, datë 10.12.2015, të Guvernatorit, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me z. E. Z.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri:

1. “*Të detyrojë Bankës e Shqipërisë t’i paguajë pagën mujore, sipas nenit 15, pika 4 e LMD-së, deri në heqjen e situatës diskriminuese*”.
2. “*Të merret masa e pezullimit nga detyra për z.A.N, znj.R.SH, z.I.M, z.A.B, z.I.XH, për t’i hapur rrugën një hetimi të pavarur*”.
3. “*T’i kthehen të gjitha ndalesat e paligjshme nga paga, si dhe të gjitha të drejtat e tjera që lindin nga lënia në heshtje e ankesave të vazhdueshme dhe të përsëritura të pretendimeve pa përgjigje, nga ana e BSH-së*”.
4. “*Duke pasur parasysh gravitetin e rëndësinë e shkeljeve të realizuara në një institucion qendror kushtetues, si dhe pasojat e diskriminimit që kanë cuar në shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, të dëmshpërblehet në mënyrë të plotë sipas nenit 38 të LMD-së, moralisht dhe financiarisht, si nga punëdhënësi, ashtu dhe nga personat që kanë përgjegjësi individuale për diskriminimin për dëmin e largimit të paligjshëm nga puna, për cënimin e integritetit psiko-fizik, të personalitetit dhe të dinjitetit njerëzor*”.

#### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me **çdo shkak tjetër***”.

Pas analizimit fillestar të informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi u evidentua se ankesa kishte mangësi të anës formale. Lidhur me këtë, ankuesit iu kërkua të plotësonte mangësitë e ankesës së tij<sup>4</sup>.

Referuar nenit 91, pika 3, të Kodit të Proçedurës Administrative, të ndryshuar, i cili parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e proçedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”*.

Me shkresën nr.725/1 prot., datë 08.09.2016, ankuesi depozitoi pranë Zyrës së KMD-së dokumentacionin e kërkuar.

- A.** Në vijim, pas analizimit në tërësi, të ankesës nr.71 Regj., datë 21.07.2016, së z. E. Z. dhe plotësimit të saj me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga KMD, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bankës së Shqipërisë me shkresën nr.725/3 prot, datë 23.09.2016 ku kërkohej informacion lidhur me pretendimet e ngritur nga ankuesi.
  - 1.** Në përgjigje të shkresës nr.725/3 prot, datë 23.09.2016, të Komisionerit, Banka e Shqipërisë dërgoi shkresën nr .4527/1 prot., datë 21.10.2016, nëpërmjet së cilës ka informuar mbi pretendimet e ankuesit, si dhe ka parashtruar argumentet e veta.

Në shkresën e sipërpërmendur, Banka e Shqipërisë ka sqaruar se z. E. Z. në asnjë rast nuk është trajtuar në mënyrë diskriminuese, qoftë nga ana profesionale, shëndetësore, politike apo të çfarëdo aspekti tjetër. Në shkresë theksohet fakti se zgjidhja e marrëdhënieve të punës është

---

<sup>4</sup> Tek çdo shkak tjetër ankuesi citon-bindjet dhe opinionet profesionale të shprehura në përmbushje të detyrimit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe interes public në Institucionin e Bankës së Shqipërisë; paragjykimet politike lidhur me përkatësinë e tij, etj.

<sup>5</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

kryer konform të gjitha procedurave të parashikuara në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Bankës së Shqipërisë<sup>6</sup>.

**C.** Në vijim të ndjekjes së procedurës hetimore për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, në datën 30.11.2016<sup>7</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë Bankës së Shqipërisë.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Përgjegjësin e Sektorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, z. E. P., i cili për shkak se ende nuk ishte njohur me kërkesat e Komisionerit lidhur me rastin e z. Zaimi, kërkoi një afat kohor një javor që BSH, të kthente përgjigje me shkrim<sup>8</sup>.

**D.** Në referencë të nenit 33, pika 8, të LMD, në datë 12.12.2016, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve në këtë proces administrativ.<sup>9</sup>

Subjekti ankues nuk ishte i pranishëm në seancë. Seanca u zhvillua me praninë e përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë, e cila u përfaqësua nga z. K. K. dhe z. E. P.<sup>10</sup>. Përfaqësuesit e këtij institucioni theksuan faktin se e gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe si rrjedhojë nuk ka ardhur si pasojë e diskriminimit siç pretendon ankuesi. Në seancë u theksua fakti se zgjidhja e marrëdhënies së punës ndërmjet palëve dhe ligjshmëria e largimit nga puna të z. E. Z. është bërë objekt gjykimi në gjykatë.

**1.** Me shkresën nr.353 Prot., datë 27.01.2017, Banka e Shqipërisë dërgoi zyrtarisht parashtrimet përkatëse, si dhe dokumentacionin provues, për të cilin u diskutua në seancë dëgjimore.

**E.** Në vijim të seancës dëgjimore, në kushtet kur, gjykata kompetente ishte duke shqyrtuar ligjshmërinë e largimit nga puna të ankuesit, nëpërmjet Vendimit nr. 11, datë 28.03.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pezulloi shqyrtimin e ankesës nr.71 Regj., datë 21.07.2016, e z. E. Z., deri në momentin, që Gjykata të shprehej me vendim të formës së prerë.

---

<sup>6</sup> Bashkëngjitur është dërguar dhe dokumentacioni shoqërues.

<sup>7</sup> Në zbatim të Urdhërit nr.186, datë 25.11.2016, të Komisionerit.

<sup>8</sup> Referuar procesverbalit të depozituar në Dosje, mbajtur në ambjentet e BSH-së, nga inspektorët e KMD-së me datë 30.11.2016.

<sup>9</sup> Në zbatim të shkresës me nr.972/1prot, datë 06.12.2016, të Komisionerit.

<sup>10</sup> Referuar Autorizimit me nr.5683 prot., datë 09.12.2016, të BSH.

1. Në vijim, me shkresën nr. 4773, datë 06.11.2019, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Komisioneri njoftohet mbi faktin se z. E. Z. ka depozituar për gjykim pranë kësaj gjykate, kërkesëpadinë me objekt - konstatim diskriminimi nga ana e Bankës së Shqipërisë etj. KMD është njoftuar nga gjykata për të marrë pjesë në cilësinë e palës së tretë në gjykimin e kësaj çështjeje.

## **F. Përfundimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar që individi, i cili që pretendon se është diskriminuar, mund të kërkojë shqyrtimin administrativ të ankesës së tij ndaj subjektit përkatës, pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Përveç sa më sipër, në referencë të nenit 36 e vijues të këtij ligji<sup>11</sup>, individit të diskriminuar i njihet e drejta, që në cilësinë e paditësit të ndjekë rrugën e shqyrtimit gjyqësor, lidhur me çështjen e konstatimit të diskriminimit, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të ligjit të sipërpërmendur.

Z. E. Z. ka depozituar në ankesën nr.71 Regj., datë 21.07.2016, pranë Komisionerit, me objekt konstatim diskriminimi për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Ndërkohë që, ankesa e tij ishte në proces shqyrtimi pranë KMD-së, ankuesi ka depozituar kërkesëpadi pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, me palë të paditur – Bankën e Shqipërisë dhe objekt padie – konstatim diskriminimi. Objekti i padisë ka në tërësi 12 kërkesa të paditësit, ku njëri prej tyre konsiston në konstatimin e diskriminimit të paditësit për periudhën, që ai ka punuar pranë Bankës së Shqipërisë. Në objektin e kërkesë padisë së Z. E.Z.citohet si vijon: “*1. Konstatimin e situatës/fakteve diskriminuese të vendosura dhe të shkaktuara nga e paditura dhe organet publike të saj, duke vendosur menjëherë detyrimin e pagimit paditësit të pagës, si Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Brendshme në Departamentin Juridik, (në masën e përfituar para vlerësimit periodik antiligjor të datave 16.10.2014 – 17.10.2014), deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi.....*”.

---

<sup>11</sup> Neni 36, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon shprehimisht: “*1.Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje.2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë Komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë.3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.4. Gjykata mund t’i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese.6. Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.*”

Në vijim, në parashtrimet e tij, z. E.Z.shprehet: “2. Më poshtë do të parashtroj disa fakte në këndvështrimin e të cilave duket qartë se e paditura dhe organet e saj publike para dhe pas nxjerrjes së Urdhërit nr. 6164 prot., datë 10.12.2015, më kanë trajtuar në mënyrë të pabarabartë, përjashtuese, shqetësuese, madje me qëllime të paligjshme dhe diskriminuese, hakmarrëse, në mënyrë të paramenduar, duke më vënë nën presion të paligjshëm, si pjesë e një praktike administrative shpërdoruese të spostimit tim nga ushtrimi i detyrës së Përgjegjës të Sektorit të Çështjeve të Brendshme dhe “mbulimit, fshehjes dhe helmimit” të të vërtetave intelektuale dhe materiale.

Më konkretisht, në datën 03.06.2014 jam shtruar me urgjencë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ku kam ndenjur i shtruar për rreth 2 javë, dhe pas diagnostikimit mjekësor spitalor dhe ndihmës urgjente, komisioni mjekësor me ka rekomanduar pushim, me raporte mjekësore të paaftësisë së përkohshme në punë, për rreth 2 muaj. Pasi u ktheva në punë në datën 18.08.2014, ishte bërë publike ngjarja e vjedhjes së shumave të konsiderueshme monetare në Departamentin e Emisionit, por drejtori A.N. dhe zëvendës drejtoresha znj. R. Sh. (eprrorja direkte) nuk dhanë asnjë informacion të nevojshëm në lidhje me detyrën time si Përgjegjës të Sektorit të Çështjes të Brendshme, fakt ky që vinte në kundërshtim me kontratën individuale me shkrim të punës, si dhe me nenin 29 shkronja j), të rregullores Nr. 21, datë 16.05.2007 “Për marrëdhëniet e punës të personelit në Bankën e Shqipërisë Me këta dy drejtues kisha pasur mosmarrëveshje parimore pune edhe më parë, për shkak të papërgjegjshmërisë në mënyrën e drejtimit të Departamentit Juridik.....”.

Edhe në vijim të kërkesë-padisë, lidhur me parashtrimet, që i përkasin pjesës, ku pretendohet diskriminim, Komisioneri konstatoi se pretendimi i Z. E.Z. në kërkesëpadi ishte i njëjtë me atë të parashtruar në ankesën nr.71 Regj., datë 21.07.2016, e depozituar pranë KMD.

Pas konstatimit të mësipërm, në referencë të nenit 36, të Kodit të Proçedurës Civile (i ndryshuar), ku parashikohet : “.....Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata....”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi, që në vijim nuk mund të shprehej më mbi ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të proçedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, si dhe mbështetur në kërkesën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka

dërguar mendim me shkrim mbi çështjen e Z. E. Z., nëpërmjet shkresës nr. 1696/1, datë 11.11.2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenin 90, pika 3 e Kodit të Proçedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar proçedurën e hetimit të ankesës nr.71 Regj., datë 21.07.2016, së z. E. Z., pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha – punesim  
Shkak - “gjendja shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”